



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 50

Prishtinë, më 24. 02. 2010, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Integritet Evropian

Në mbledhje morën pjesë: Zylfije Hundozi, Bujar Bukoshi, Džezair Murati, Edita Tahiri, Njomza Emini, Nait Hasani dhe Naser Rugova.

Munguan: Fatmir Rexhepi e Mursel Halili.

Me ftesë: **Ahmet Shala** – ministër i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha dhe Adelina Demolli.

Pjesëmarrës të tjerë: Blerim Vela dhe Marie Berishaj - përfaqësues nga OSBE - ja, Dardan Sadriu dhe Novitet Nezaj - AKZHIE, Isuf Zejna - KDI, Besart Mustafa - praktikant, Mimoza Gojani- Ambasada Britanike, Rexhep Varolli - Ministria e Ekonomisë dhe Financave.

Mbledhjen e kryesoi Zylfije Hundozi - kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të datës 16. 02. 2010,
3. Prezantim i ministrit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, **Ahmet Shala**,
4. Memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Komisionit për Integritet Evropian dhe zëvendëskryeministrit të Qeverisë së Kosovës,
5. Shqyrtimi i Projektligjit për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE- s,
6. Të ndryshme.

Kryesuesja konstatoi se ishin plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen.

Kryesuesja, për shkak të angazhimit të ministrit, kërkoi të fillojnë me pikën e tretë të rendit të ditës.

3. Prezantim i Ministrit të Ekonomisë dhe Financave, Ahmet Shala

Kryesuesja - Tha se Raporti i Progresit për Kosovën është publikuar në muajin tetor. Komisioni për Integritet Evropian e ka hartuar Planin e Veprimit, për kriteret politike, ekonomike dhe për standardet evropiane. Andaj arsyeja pse ju kemi ftuar sot është ta dimë se çka ndërmorët deri më sot për t'i përmbushur sfidat që kanë dalë për Ministrinë tuaj. Dëshiroj të dijë për kursin e paraqitur, për kornizën afatmesme e cila duhet të përmirësohet... përdorimin e kornizës afatmesme dhe bilancin neto të kapitalit.

Ministri Ahmet Shala – Tha se shumë nga sfidat e dala në Reportin e Progresit nuk janë në mënyrë specifike të adresuara për Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, por disa prej tyre janë më fuqishëm të lidhura e që Ministria ka një rol të rëndësishëm në ato sfida. Lidhur me Kornizën afatmesme për vitin 2011 - 2013 të shpenzimeve Qeveria do ta paraqesë për miratim në fund të muajit prill. Kjo kornizë para së gjithash është shprehje e kulturës së punës së shoqërisë kosovare, e cila gërshetohet me veprimet e secilës organizatë buxhetore. Ne në çdo fund të janarit e kemi agjendën në vija të trasha për prioritetet e Qeverisë, të cilën e shndërrojmë në prioritetet dhe në bazë të prioritetëve e rangojmë planifikimin buxhetor me anë të modelit makroekonomik, i cili harmonizohet me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe me institucionet e tjera. Sa i përket devijimeve të mundshme, që i kemi nga kjo kornizë, janë si pasojë e presionit ad hoc që e kemi, e të cilat presione do të jenë në skenën kosovare edhe për disa vite. Lidhur me menaxhimin e financave publike ka progres. Bashkë me Bankën Botërore është bërë një Plan Aksionar Veprimesh, ku janë identifikuar mbi 140 pozicione të përmirësimit dhe të cilat kanë ngritje në pozicione. Inflacioni është për shkak se Kosova nuk e ka valutën vendore në Bankën Qendrore, po ashtu kjo varet edhe nga balanca ndërmjet eksportit dhe importit, si dhe nga rrjedhjet makroekonomike në botë. Inflacioni në vitin 2008 ka qenë i ndikuar nga rritja e naftës. Tani shkalla e inflacionit është në shkallë të kontrollueshme. Ne nuk mund të bëjmë shumë në uljen e inflacionit. Forma e ndikimit të Qeverisë në ndikimin e kalimin të kësaj gjendje është miratimi i Ligjit për huan publike. Tani jemi në fazën e përgatitjes së Ligjit për instrumentet e pagesës, ku do të kemi mundësi që nga fundi i vitit të emetojmë letra me vlerë. Roli i letrave me vlerë do të jetë i dyfishtë, përveç politikës fiskale do të kemi mundësi që paratë e investuara në botën e jashtme të investohen në Kosovë dhe përmes emetimeve të bonave të thesarit do të kenë mundësi të plotësohet deficiti tregtar. Lidhur me çështjen e inflacionit jemi në negociim me Fondin Monetar Ndërkombëtar, sepse shqetësimi i tyre ka qenë të mos bëjmë investime kapitale, pa kufi, sepse ato tërheqin shpenzime të tjera të mirëmbajtjes dhe kështu do të ngarkojë buxheti. Qeveria është orientuar në zgjidhjen e problemeve sociale duke bërë rritjen ekonomike. Buxheti i vitit 2010 ka qenë parakusht që FMN - ja të shkruajë letër certifikimi pozitive. Shtoi se sikur të mos miratohej Ligji për buxhetin sipas kërkesës së FMN- së do të rrezikohet fitimi i fondit prej 50 milionësh euro. Sa i përket Ligjit mbi Bankën Qendrore tha se së shpejti do të bëhet harmonizimi i tij. Planifikim i dobët i buxhetit nuk është çështje vetëm e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, sepse secila organizatë buxhetore sjell planifikimin buxhetor të tyre. Ne, si Ministri, jemi duke punuar shumë mirë. Nëse këtë vit arrijmë në programin e FMN - së, do të thotë që punët i kemi shumë më mirë se sa i kishim. Shpresoj që Banka Botërore, pa e mbyllur vitin fiskal në muajin qershor, do të lejojë shumën prej 20 milionë eurosh. Jam në kontakte me Komisionin Evropian dhe jemi akorduar që Komisioni Evropian të vijë së paku dy herë në vit për të bërë mbikëqyrjen, kontrollin dhe vlerësimin për të gjitha këto.

Kryesuesja – Tha se Raporti i Progresit është publikuar në tetor, ndërsa Buxheti i Kosovës është miratuar në dhjetor, mirëpo Agjenda Evropiane nuk është paraparë në buxhetin e vitit 2010. Po ashtu

nuk është paraparë buxhet as për Planin e Veprimit të Qeverisë për Integrimet Evropiane. Andaj deshi të dijë se a ka mbulesë buxhetore për to.

Ministri Ahmet Shala – Tha nuk ka linjë të veçantë për këto veprime, mirëpo secila ministri dhe dikaster ka identifikuar nevojat e tyre buxhetore për detyrimet që dalin për integrimin evropian. Në secilën ministri ka një linjë të veçantë për këto nevoja të identifikuara. Ne, si ministri, nuk mund të ndërhyjmë te ministrinë e tjera, sepse secila ka prioritetet e tyre për vitet e ardhshme. Ne në bazë të kompetencave si ministri kemi lejuar edhe paga shtesë për stafin e Agjencisë për Zhvillim dhe Koordinim të Integrimi Evropiane. Ne nga Fondi i Gradës Speciale kemi ndarë 1 milion e 100 mijë euro për pozicione të specializuara dhe në çdo dikaster të paguajnë rrogë shtesë për specialistët e degëve përkatëse.

Naser Rugova – Tha se si Komision na janë dashur dy vite ta orientojmë këtë formë të debatit institucional në këtë nivel. Kërkoj që në procesin e integrimin në BE të jenë unik dhe të hartohen qëndrime me objektiva nacionale. Disa gjëra që diskutohen në media nganjëherë marrin edhe karakter tjetër. Sa i përket infrastrukturës ligjore, që ka të bëjë me agjendën evropiane për dikasterin që e mbulon, i inkurajoi që së bashku me Grupet Punuese të punojnë në këtë drejtim. Kërkoj që të shikohet mundësia e krijimit të sistemit elektronik për prokurimin publik, që është miratuar nga vendet në rajon. Duhet të dalim nga korniza e asaj se një ligj i mirë nga vendi i rajonit do të jetë i miratueshëm edhe në vendin tonë. Pra duhet të hartohen ligjet sipas nevojave tona. Sa i përket presioneve për planifikimin buxhetor tha se i kuptoj këto presione, por duhet krijuar një kulturë institucionale të planifikimit. Jam në dijeni se nga të gjitha organizatat buxhetore ju vijnë kërkesa me interferime dhe të pa planifikuara. Kërkoj që t' u thuhet stop kontratave njëburimore. Sa i përket cilësisë së investimeve kapitale tha se është sfidë tjetër. Kuvendi ka gatishmërinë që të gjitha ligjet cilësore, që do të gjejnë zbatim të përkrahën. Ne nuk e dimë nëse do të filloj Projekti i madh, siç është autostrada, cili është participimi i Qeverisë së Kosovës, ndërrohet traseja, janë dhënë 5 milionë e 200 mijë euro viteve të fundit për një projekt tjetër të fizibilitetit. Për fund tha se kërkojmë që ju si ministër të ndikoni në mënyrë institucionale, sepse është krijuar një shprehje që të përcillen një pako ligjesh dhe po anashkalohen komisionet funksionale dhe mandej po bien ndesh me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve.

Ministri Ahmet Shala - Tha se shumica e shqetësimeve që i paraqite janë edhe shqetësime tona. Ne, si ministri, veprojmë konform proceduarave dhe ligjeve. Unë nuk guxoj të shoh vetën në rolin e auditorit, sepse secili organ ka përgjegjësit e veta për ndikimet buxhetore. Sa i përket Ligjit për Prokurimin Publik fitohet përshtypja se është përgjegjësi e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, që ta bëjë sponzorizimin. Mirëpo një gjë e tillë nuk është në kompetencën tonë. Këtë duhet ta bëjë Agjencia për Prokurim. Para disa ditësh Ministria e Administratës Publike ka proceduar Ligjin për Prokurimin Publik. Ne do ta mbështesim plotësisht atë. Njoftoi se është duke u bërë amendamenti i Ligjit për Partneritetin Publiko - Privat dhe Ligjin për Financimin Publike.

Dzezair Murati – Theksoi se për të diskutuar me ministrin kishte për të hapur shumë tema, por u përqendrua vetëm në temat që i përkasin komuniteteve. Ai kishte vërejte sepse konsideroi se investimet që po bëhen nga Qeveria po fokusohen vetëm në komunitetin serb. Vetëm ata nuk e përbëjnë multietnicitetin dhe se shumë ekspertë vendorë, që i përkasin komuniteteve nuk shfrytëzohen dhe pastaj ata po detyrohen të dalin nga Kosova. Në vazhdim tha se Ministria për Komunitete dhe Kthim është shndërruar në ministri vetëm për një komunitet dhe për shumë probleme i është ndaluar të diskutohet publikisht. Nuk ka investime në bujqësi, në pushtetin lokal dhe në fusha të tjera, dhe si përfaqësues i komunitetit nuk ka kurrfarë ndikimi në Ministrinë për Kthim. Është e pa kuptim të neglizhohen ekspertët nga ana e komuniteteve. Dhe ministrin i tha: a do ta kuptoni se edhe minoritetet e tjera do të jetojnë në Kosovë? Pastaj shtoi se kur është në pyetje privatizimi, asnjëherë tenderët nuk i kanë marrë njerëzit që i përkasin komuniteteve. Në fund tha se me këtë gjendje që është tani nuk mund të pajtohem.

Bujar Bukoshi – Pyeti ku konsiston strategjia e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave në konsolidimin e arkës së shtetit dhe koordinimi i juaj me institucionet e tjera. Po ashtu deshi të dijë edhe për përqindjen e diskrepancës ndërmjet eksportit dhe importit dhe ekonomisë gri.

Ministri Ahmet Shala - U pajtua që Qeveria duhet të ketë më shumë kujdes edhe për minoritetet e tjera, jo serbe. Unë tha nuk kam çelës magjik për t'i zgjidhur këto çështje dhe ne nuk kemi fonde të veçanta si ministri për çështje të tilla. Njoftoi që njëri nga anëtarët e Bordit për Ankesa është nga komuniteti boshnjak. Sa i përket plotësimit të arkës së shtetit, vitin e kaluar ka qenë viti më sfidues, andaj ka qenë shumë e vështirë të mbushet arka e shtetit. Kanë rënë investimet e huaja, çmimet për importe dhe nafta, ndërsa ne i kemi tejkeluar për 2% planifikimet tona. Të hyrat nga komunat kanë qenë 46% më shumë se që janë planifikuar vitin e kaluar. Për këtë vit kemi planifikuar një ngritje në administratën tatimore të planit. Besoi se fiskalizimi i mbi 40 mijë bizneseve ka qenë një sukses shumë i madh i Administratës Tatimore. Njoftoi se në kuadër të ministrisë kanë futur njësinë për hetime dhe se është ndaluar që nga thesari të bëhen pagesa për ato ndërmarrje të cilat kanë borxhe ndaj Administratës Tatimore ose Doganave. Sa i përket ekonomisë informale tha ka plan Aksionar me të cilin kërkohet që Gjykatat të jenë më efikase. Ne i procedojmë, mirëpo lëndët nuk procedohen. Deficiti tregtar është 88 me 12%. Sa i përket eksportit tha se ka filluar të ketë pak eksport. Deri më tani kemi shumë premtime se do të ketë lëvizje në këtë drejtim, përkundër faktit që presidencën e CEFTA- s e udhëheq Serbia.

Kryesuesja - Tha se sa i përket Gjykatave ato nuk na raportojnë për shkak se janë institucione të pavarura. Ndërsa sa i përket CEFTA- s në mbledhjen e ardhshme do ta ftojë ministrin e Tregtisë dhe Industrisë. Në vitin 2008 është paraparë themelimi i Grupeve Punuese me qëllim të decentralizimit të punës për agjendën evropiane, por të cilat grupe tani nuk janë më funksionale. Komisioni Punues për Integritet Evropian, në të cilin jeni bashkëkryesues, është mbledhur vetëm dy herë. Pyeti si ekziston mundësia që ju ta funksionalizoni këtë komision.

Ministri Ahmet Shala - Tha se nuk jam adhures i decentralizimit të madh e as i centralizimit të madh, sepse të dyja janë të rrezikshme. Sa i përket decentralizimit të thesarit tha kam qenë shumë i kujdesshëm dhe e kam pasur përkrahjen e FMN- së dhe të Komisionit Evropian. Konsideroi që duhet të jetë një grup punues, ku ministria duhet të ketë rol mbështetës. Komisioni duhet të ekzistojë, mirëpo tani koordinimi i tyre nuk dihet nga kush bëhet.

Edita Tahiri - Tha se ekonomia është sfida më e madhe. Përveç që Raporti i 2009 nuk ka dalë më i mirë se ai i 2008, ka rënie të investimeve të huaja në ekonomi. Në këtë rënie ka ndikuar kriza ekonomike globale por nuk është i vetmi faktor i cili ka shkaktuar rënie të investimeve. Ndërsa sipas saj investimet e huaja janë njëri ndër faktorët kryesorë për zhvillim ekonomik. Pyeti se cilat janë arsyet e rënies së investimeve dhe cilat masa u ndërmorën për rritjen e investimeve.

Ministri Ahmet Shala - Tha se nuk është vetëm kriza ekonomike globale që ka ndikuar në rënien e investimeve. Ndër arsyet e tjera është edhe mungesa e ofertave për projekte atraktive, sepse kur ka projekte interesante ka edhe interesim. Kjo më së miri konfirmohet me rastin e aeroportit, ku janë të interesuara dhjetë kompani më të fuqishme evropiane. Po ashtu edhe ngadalësimi i hedhjes në treg të ndërmarrjeve shoqërore për privatizim ka krijuar një vakum të investitorëve. Ne tha do të bëjmë përpjekje që përveç taksave të punojmë edhe në tejkalimin e burokracisë, luftimit të korrupsionit, shpejtësinë e lëshimit të certifikatave të bizneseve. Besojmë që këtë vit do të bëjmë përmirësime. Nëse arrijmë që të bëjmë konsecionimin e aeroportit, Post- Telekomit të Kosovës, në pesë vjetet e ardhshëm do të kemi më shumë dinamikë të investimeve të huaja. Në aspektin e legjisllacionit si Ministri e Ekonomisë dhe Financave, jemi mirë, taksat në të ardhurat individuale janë më të ultat në Evropë. Jemi në presion të kalimit të disa ligjeve, të cilat duhet t'i kalojmë gjithsesi, por të cilat nuk do të ndikojnë pozitivisht në gjendjen në të cilën jemi. Fuqizimi i Agjencisë për promovimin e investimeve duhet të jetë agjendë e jona dhe e juaja.

Kryesuesja e falënderoi Ministrin për informatat e ofruara para Komisionit.

2. Miratimi i procesverbalit të datës 16. 02. 2010,

Procesverbali i datës 16.02.2010 u miratua pa vërejtje.

4. Memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Komisionit për Integritet Evropian dhe Zëvendëskryeministrit të Qeverisë së Kosovës,

Kryesuesja - I njoftoi anëtarët e Komisionit se me qëllim të rritjes së bashkëpunimit në mes të Komisionit për Integritet dhe Agjencisë për Koordinim dhe Zhvillim të Integriteteve Evropiane është hartuar Memorandumi i mirëkuptimit nga eksperti Kaloyan Simeonov. Kërkoj nga deputetët që të paraqesin propozimet e tyre për këtë memorandum bashkëpunimit.

Pasi nuk kishte propozime nga deputetët Kryesuesja konstatoi se Komisioni një zëri nxori këtë

Përfundim

Miratohet memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Komisionit për Integritet Evropian dhe zëvendëskryeministrit të Qeverisë së Kosovës dhe i njëjti do të nënshkruhet nga kryetarja e Komisionit dhe zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE - së

Kryesuesja, referuese e këtij projektligji paraqiti Raportin për këtë projektligj.

Kryesuesja - Tha se ky projektligj mund të procedohet më tutje, sepse ky ligj nuk i cenon parimet e *acquis* komunitare.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Projektligji për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë me amendamentet e Komisionit Funkcional, është në harmoni me *acquis* komunitare.

6. Të ndryshme.

a) Caktimi i deputetëve që do të shkojnë për vizitë në Bullgari.

Kryesuesja i njoftoi anëtarët e Komisionit se me kërkesën e Komisionit në TAIEX është miratuar vizita e katër pjesëmarrësve në Bullgari. Andaj kërkoj të caktohen pjesëmarrësit për këtë vizitë.

Pas diskutimeve të anëtarëve të Komisionit kryesuesja konstatoi se Komisioni nxori këtë

Përfundim

Pjesëmarrës për vizitë në Bullgari do të jenë: Zylfije Hundozi, Bujar Bukoshi, Edita Tahiri, dhe Njomza Emini.

b) Njoftim për seminar të organizuar me kërkesën e Komisioni për Integritime Evropiane dhe bashkëpunim me TAIEX- in.

Kryesuesja i njoftoi se Komisioni Evropian në bashkëpunim me Komisionin për Integritime Evropiane të Kuvendit të Kosovës, në organizimin e TAIEX-it do të mbajnë seminar dyditor për përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës për sfidat e miratimit dhe implementimit të *acquis* komunitare. Seminari fillon nesër në orën 09: 00.

Mbledhja përfundoi në orën 13: 40

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisioneve

Kryetare e Komisionit

Zylfije Hundozi